



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 10.02.2017

Vendim
Nr. 26, datë 10.02.2017

**PËR SAKTËSIM TË VENDIMIT NR. 39 DATË 06.10.2016 TË SENATIT
AKADEMIK "PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË PERSONELIT
NDIHMËSAKADEMIK ME KARAKTER MËSIMOR DHE PERSONELIT
NDIHMËSAKADEMIK ME KARAKTER ADMINISTRATIV"
TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË**

Në mbështetje të nenit 66 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", "Personeli ndihmësakademik", në funksion të hartimit të Strukturës së Përgjithshme të Institucionit dhe numrit të personelit të Institucionit në të gjitha nivelet, Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.02.2017

VENDOSI:

1. Të saktësojë shkronjën **b**, pika **2** në Vendimin nr. 39, datë 06.10.2016 të Senatit Akademik "Për përcaktimin e kategorive të personelit ndihmësakademik me karakter mësimor dhe personelit ndihmësakademik me karakter administrativ", si vijon:

b) Në nivel njësie kryesore: punonjësit e kryesekretarive të cilët krijojnë, ruajnë, administrojnë dhe shërbejnë dokumentacionin e procesit mësimor sipas nenit 101 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", specialistët pranë Dekanëve, punonjësit ndihmës të departamenteve apo specialistët pranë qendrave kërkimore shkencore dhe çdo pozicion pune tjetër që vepron brenda fushës së përshkruar në nenin 66, pika 3 e ligjit të referuar.

2. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.